



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 817/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ragip Mehmeti, kandidat për anëtar të kuvendit komunalë në Lipjan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur për shkak të parregullsive dhe të mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 12.11.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** si e palejueshme ankesa e Ragip Mehmeti, kandidat për anëtar të kuvendit komunalë në Lipjan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 11.11.2013, nga Ragip Mehmeti, kandidat për anëtar të kuvendit komunalë në Lipjan nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ne të cilën pretendon se me datën 3 nëntor 2013 gjatë ditës së zgjedhjeve janë bërë manipulime gjatë numërimit të votave nga ana e komisionarëve gjatë përpilimit të raportit në vendvotim ku janë shënuar më pak vota se sa janë në kutitë e votimit, prandaj me këtë rast parashtresuesi i ankesës kërkon që të bëhet rinumërimi i votave në këto qendra si më poshtë: QV Magure 1302 vv 01.02.03.04.05.06  
QV Rufc i Ri 1323e vv01.02.03 dhe QV Resinovec 1324e vv 01.02.03

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

### Ankesa është e palejuar

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e palejuar ngase rezultatit preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment dhe po ashtu ankesa në fjalë për rezultat preliminar në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së parasheh se

“Çdo anëtarë i komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje të Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në përputhje me këtë ligj“. Në rastin konkret ankesa është parashtruar nga kandidati për anëtarë të kuvendit komunal që nuk është person i autorizuar sipas ligjit të parashtrori ankesë sipas dispozitës së lartcekur.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

A nr. 817/2013 më datën 12.11.2013

**Kryesuesi i Panelit  
Xheydet Abazi**



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.